

Legal Newsletter

December 2025

Udhëzim i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 7, datë 20.11.2025 'Për mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, elektronike dhe/ose audiovizive, si dhe përjashtimet për qëllimet e posaçme të përpunimit'

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri ka nxjerrë Udhëzimin nr. 7, i cili përcakton rregulla për mediat e shkruara, elektronike dhe audiovizive mbi mënyrën se si duhet të përpunohen të dhënat personale, me përjashtime të posaçme për veprimtarinë gazetarie.

Zhvillimet kryesore:

- E drejta për t'u harruar: Heqja e të dhënave personale të panevojshme, të përpunuara në mënyrë të paligjshme, ose që cenojnë privatësinë.
- Balancimi i privatësisë dhe lirisë së shprehjes: Vlerësimi i rolit publik, natyrës së informacionit dhe kontekstit të shpërndarjes.
- Mbrojtja e të miturve: Mos publikimi i të dhënave identifikuese ose i imazheve në çështje penale; kërkohet pëlqimi i prindërve për intervista/pjesëmarrje në media, me përjashtime të kufizuara.
- Të dhënat sensitive: Përpunim i kufizuar (p.sh., shëndeti, origjina racore/etnike), që përgjithësisht kërkon pëlqim, përveç rasteve kur ka interes publik.

Guideline of the Commissioner for the Right to Information and Protection of Personal Data No. 7, dated 20 November 2025, "On the protection of personal data in the print, electronic and/or audiovisual media, as well as the exemptions for special processing purposes."

The Albanian Commissioner for the Right to Information and Personal Data Protection has issued Directive No. 7, setting rules for written, electronic, and audiovisual media on how personal data must be processed, with targeted exemptions for journalistic activities.

Key developments:

- Right to be forgotten: Removal of unnecessary, unlawfully processed, or privacy-infringing personal data.
- Balancing privacy and expression: Assess public role, nature of information, and dissemination context.
- Protection of minors: No identifying data or images in criminal cases; parental consent for interviews/media participation, with limited exceptions.
- Sensitive data: Restricted processing (e.g., health, racial/ethnic origin), generally requiring consent unless public interest applies.

- Arkivat e gazetarëve/medias: Lejohet përpunimi për qëllime historike, kërkimore ose statistikore me masa mbrojtese të përshtatshme.
- Figurat publike: Të dhënat personale duhet të publikohen vetëm kur lidhen drejtpërdrejt me veprimtarinë publike, duke respektuar parimin e proporcionalitetit dhe interesin publik.

Ky udhëzim thekson rëndësinë në rritje të mbrojtjes së të dhënave në epokën digjitale, duke i nxitur organizatat mediatike të ndjekin një qasje të kujdesshme dhe të përgjegjshme. Zbatimi është thelbësor për të shmangur sanksionet dhe, më e rëndësishmja, për të krijuar një mjedis mediatik që është njëkohësisht informues dhe respektues ndaj të drejtave të individit.

Burimi: Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë (Link)

- Journalistic archives: Processing allowed for historical, research, or statistical purposes with appropriate safeguards.
- Public figures: Personal data should be published only when directly tied to public activities, following proportionality and public interest.

This instruction underscores the growing importance of data protection in the digital age, urging media organizations to adopt a meticulous and responsible approach. Compliance is essential to avoid penalties and, more importantly, to foster a media environment that is both informative and respectful of individual rights.

Source: Official Gazette of the Republic of Albania (Link)

Udhëzim i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 8, datë 20.11.2025 'Për kriteret shtesë për akreditimin e organizmave certifikues.'

Një udhëzim i ri që përcakton kritere shtesë për akreditimin e organizmave certifikues është nxjerrë nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Këto kritere plotësojnë Ligjin nr. 124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe standardin ISO 17065, duke forcuar kuadrin e certifikimit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe duke prezantuar kritere të reja gjithëpërfshirëse për akreditimin e organizmave certifikues të përpunimit të të dhënave personale.

Zhvillimet kryesore përfshijnë:

- Kontroll të shtuar: Organizmat certifikues do të përballen me kërkesa më të rrepta, duke garantuar paanshmëri, pavarësi, konfidencialitet, llogaridhënie dhe përgjegjshmëri në veprimtarinë e tyre.
- Korniza të fuqizuara: Paraqiten kritere të detajuara për strukturën organizative, duke kërkuar staf të specializuar juridik dhe teknik, si dhe metodologji rigoroze certifikimi.
- Siguri për klientët: Theksohet trajtimi transparent i ankesave, monitorimi i vazhdueshëm i klientëve dhe dokumentimi i mirëstrukturuar, për të ofruar më shumë garanci për bizneset që kërkojnë certifikim.

Instruction of the Commissioner for the Right to Information and Protection of Personal Data No. 8, dated 20 November 2025, "On additional criteria for the accreditation of certification bodies."

A new directive setting additional criteria for accrediting certification bodies has been issued by The Albanian Commissioner for the Right to Information and Data Protection. These criteria supplement Law No. 124/2024 on the Protection of Personal Data and ISO 17065, strengthening the certification framework for personal data protection and introduces comprehensive new criteria for the accreditation of personal data processing certification bodies.

Key developments include:

- Enhanced Scrutiny: Certification bodies will now face stricter requirements, ensuring impartiality, independence, confidentiality, accountability, and responsibility in their operations.
- Robust Frameworks: Detailed criteria are outlined for organizational structure, mandating specialized legal and technical staff, and rigorous certification methodologies.
- Client Assurance: A focus on transparent complaint handling, continuous client monitoring, and robust documentation will provide greater assurance to businesses seeking certification.



Akreditimi, i menaxhuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, për një afat pesëvjeçar, do të jetë nën vëzhgimin e Komisionerit, i cili ruan autoritetin për të mbikëqyrur pajtueshmërinë, për të kryer audit ime dhe për të propozuar sanksione ose revokime.

Këto ndryshime nënvizojnë angazhimin e Shqipërisë për t'u përafruar me praktikat më të mira ndërkombëtare në privatësinë e të dhënave. Bizneset duhet të vlerësojnë pajtueshmërinë e tyre aktuale në përpunimin e të dhënave dhe të përgatiten për këto kërkesa të përditësuara, për të siguruar vazhdimësinë e pajtueshmërisë dhe për të ruajtur besimin te klientët e tyre.

Burimi: Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë (Link)

Accreditation, managed by the General Directorate of Accreditation for a five-year term, will be under the watchful eye of the Commissioner, who retains authority to oversee compliance, conduct audits, and propose sanctions or revocations.

These changes underscore Albania's commitment to aligning with international best practices in data privacy. Businesses should assess their current data processing compliance and prepare for these updated requirements to ensure continued adherence and maintain trust with their clients.

Source: Official Gazette of the Republic of Albania (Link)



Udhëzim i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 9, datë 20.11.2025 'Për kriteret e përgjithshme për certifikimin dhe për dhënien e vulave dhe të shenjave të mbrojtjes së të dhënave personale'.

Në një lëvizje për të forcuar më tej mbrojtjen e të dhënave personale, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka nxjerrë një Udhëzim të ri që përcakton kritere të gjithanshme për certifikimin dhe lëshimin e vulave dhe shenjave të mbrojtjes së të dhënave personale. Ky zhvillim është thelbësor për të gjitha subjektet që merren me përpunimin e të dhënave personale në Shqipëri.

Ky kuadër i ri prezanton një proces formal certifikimi, i vlefshëm deri në tre vjet, i krijuar për të konfirmuar se aktivitetet e përpunimit të të dhënave personale respektojnë mekanizmat e miratuar nga Komisioneri.

Instruction of the Commissioner for the Right to Information and Protection of Personal Data No. 9, dated 20 November 2025, "On the general criteria for certification and for the issuance of data protection seals and marks."

In a move to further strengthen personal data protection, the Albanian Commissioner for Information and Personal Data Protection has issued a new Instruction establishing comprehensive criteria for the certification and issuance of personal data protection seals and marks. This development is crucial for all entities involved in personal data processing within Albania.

This new framework introduces a formal certification process, valid for up to three years, designed to confirm that personal data processing activities adhere to mechanisms approved by the Commissioner.

Për organizatat që kërkojnë këtë certifikim, kërkesat kryesore tani përfshijnë:

- Sisteme të Integruara të Menaxhimit: Kontrolluesit/përpunuesit e të dhënave duhet të zbatojnë si Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (ISMS) në përputhje me ISO/IEC 27001, ashtu edhe Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Personal (PIMS) të harmonizuar me ISO/IEC 27701.
- Parimet Bazë të Mbrojtjes së të Dhënave: Respektimi i parimeve themelore si ligjshmëria, transparenca, minimizimi i të dhënave, saktësia, kufizimi i ruajtjes, integriteti, konfidencialiteti dhe llogaridhënia është parësor.
- Gatishmëria Operacionale: Organizatat duhet të vendosin role dhe përgjegjësi të qarta, procedura të fuqishme për menaxhimin e shkeljeve të të dhënave, dhe mekanizma për lehtësimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave.
- Menaxhim Proaktiv i Rrezikut: Vlerësime të detyrueshme të rrezikut dhe Vlerësime të Ndikimit në Mbrojtjen e të Dhënave (DPIA) kërkohen për të identifikuar dhe zbutur rreziqet e mundshme.
- Masa Teknike dhe Organizative Mbrojtëse: Zbatimi i masave të forta teknike dhe organizative, përfshirë pseudonimizimin, kriptimin, kontrollin e aksesit, testimin e vazhdueshëm të sigurisë, dhe garancitë për transferimet ndërkombëtare të të dhënave, është tashmë parakusht.
- Angazhim për Përmirësim të Vazhdueshëm: Dëshmimi i angazhimit dhe menaxhimit, politika të dokumentuara, trajnimi i vazhdueshëm, auditimet e brendshme dhe përmirësimi i vazhdueshëm i PIMS janë thelbësore për certifikim.

Trupat e akredituara të certifikimit do të luajnë një rol thelbesor në vlerësimin dhe lëshimin e këtyre certifikimeve, në mbajtjen e listave publike të subjekteve të certifikuara dhe në raportimin te Komisioneri. Mospërputhja me këtë udhëzim mund të çojë në pezullim ose revokim të certifikimit dhe përbën shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ky standard i ri i certifikimit sinjalizon një fokus të shtuar ndaj maturitetit të privatësisë së të dhënave në Shqipëri. Organizatat inkurajohen të rishikojnë praktikat e tyre të trajtimit të të dhënave dhe të kërkojnë udhëzime nga ekspertët për të siguruar përputhshmëri të plotë dhe për të dëshmuar angazhimin e tyre për mbrojtjen e të dhënave personale.

Burimi: Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë (Link)

For organizations seeking this certification, key requirements now include:

- Integrated Management Systems: Data controllers/processors must implement both an Information Security Management System (ISMS) compliant with ISO/IEC 27001 and a Personal Information Management System (PIMS) aligned with ISO/IEC 27701.
- Core Data Protection Principles: Adherence to fundamental principles such as lawfulness, transparency, data minimization, accuracy, storage limitation, integrity, confidentiality, and accountability is paramount.
- Operational Readiness: Organizations must establish clear roles and responsibilities, robust procedures for managing data breaches, and mechanisms for facilitating data subject rights.
- Proactive Risk Management: Mandatory risk assessments and Data Protection Impact Assessments (DPIA) are required to identify and mitigate potential data protection risks.
- Technical and Organizational Safeguards: Implementation of strong technical and organizational measures, including pseudonymization, encryption, access controls, continuous security testing, and safeguards for international data transfers, is now a prerequisite.
- Commitment to Continuous Improvement: Demonstrating management commitment, documented policies, ongoing training, internal audits, and continuous improvement of the PIMS are essential for certification.

Accredited certification bodies will play a vital role in evaluating and issuing these certifications, maintaining public lists of certified entities, and reporting to the Commissioner. Non-compliance with this instruction could lead to suspension or revocation of certification and constitutes a violation of personal data protection law.

This new certification standard signals a heightened focus on data privacy maturity in Albania. Organizations are encouraged to review their data handling practices and seek expert guidance to ensure full compliance and demonstrate their commitment to protecting personal data.

Source: Official Gazette of the Republic of Albania (Link)



Projektligji "Për Tregjet e Kripto-Aseteve"

Parlamenti i Shqipërisë ka miratuar së fundmi “Ligjin përTregjet e Kripto-Aseteve” (“Ligji për Tregjet e Kripto-Aseteve”). Ky akt normativ i ri do të hyjë në fuqi më datë 1 Mars 2026 dhe është tërësisht i përafruar me Rregulloren e Bashkimit Evropian për Tregjet në Kripto-Asete nr. 2023/1114.

Ky zhvillim ligjor pritet të ndikojë të gjithë individët dhe subjektet juridike që veprojnë në fushën e emetimit, ofertës publike, tregtimit apo ofrimit të shërbimeve të lidhura me kripto-asete, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Pikat Kryesore të Ligjit:

- Ligji përcakton rregulla të detajuara për ofertën publike dhe pranimin për tregtim të kripto-aseteve, njësoj si dhe kërkesat specifike për Ofruesit e Shërbimeve të Kripto-Aseteve (CASP), si edhe për emetuesit e Tokenave të Referuara në Asetet (ART) dhe Tokenave të Parasë Elektronike (EMT).
- Qëllimet thelbësore të këtij ligji përfshijnë: nxitje e transparencës, garantimin e mbrojtjes së investitorëve, promovimin e integritetit të tregut si dhe parandalimin e manipulimit të tregut të kripto-aseteve.
- Përgjegjësia rregullatore dhe mbikëqyrëse ndaj veprimtarisë sipas këtij ligji ndahet midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Bankës së Shqipërisë. AMF ngarkohet me mbikëqyrjen e ofertave publike të kripto-aseteve të zakonshme, me autorizimin dhe mbikëqyrjen e CASP-ve, si dhe parandalimin e abuzimit të tregut; ndërsa Banka e Shqipërisë është autoriteti përgjegjës për licencimin dhe mbikëqyrjen e emetuesve të ART-ve dhe EMT-ve.
- Ligji parashikon në mënyrë të qartë përjashtime për disa kategori kripto-asetesh, konkretisht: tokenat unikë dhe të pakëmbyeshëm (NFT), instrumentet financiare në kuptimin e legjislacionit përkatës dhe produkte të tjera financiare tashmë të rregulluara si depozitat, produktet e sigurimit dhe fondet e pensioneve.

Draft Law "On Crypto-Asset Markets"


The Albanian Parliament has recently introduced the "Law on Crypto-Asset Markets". This new legal framework is set to come into force on March 1, 2026 and is fully aligned with the European Union's Markets in Crypto-Assets Regulation (EU) 2023/1114.

This change is expected to affect all individuals and legal entities engaged in the issuance, public offering, trading, or provision of services related to crypto-assets within the Republic of Albania.

Key Points:

- The law establishes detailed rules for the public offering and admission to trading of crypto-assets, as well as specific requirements for Crypto-Asset Service Providers (CASPs), and issuers of Asset-Referenced Tokens (ARTs) and Electronic Money Tokens (EMTs).
- Key objectives include ensuring transparency, safeguarding investor interests, promoting market integrity, and preventing market manipulation.
- Regulatory and supervisory responsibilities are divided between the Financial Supervisory Authority (AMF) and the Bank of Albania. The AMF will oversee public offerings of general crypto-assets, authorization and supervision of CASPs, and market abuse prevention while the Bank of Albania will be responsible for the authorization and supervision of ART and EMT issuers.
- The law specifically excludes certain types of crypto-assets, such as unique and non-fungible tokens, financial instruments, and existing regulated financial products (e.g., deposits, insurance products, pension funds).





Hapat që duhen ndjekur:

- Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e kripto-aseteve në territorin shqiptar duhet të analizojnë në mënyrë të hollësishme mënyrën e organizimit, produktet dhe shërbimet aktuale me qëllim identifikimin e ndikimeve të mundshme dhe sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat e reja ligjore dhe rregullatore.
- Ofruesit e Shërbimeve të Kripto-Aseteve (CASP) dhe/ose emetuesit e ART/EMT duhet të njihen dhe të përmbushin kushtet ligjore për licencim/autorization dhe kërkesat për mbikëqyrje të vazhdueshme, për të qenë në përputhje me të drejtën pozitive shqiptare.
- Duhet të rishikohen dhe përditësohen politikat e brendshme dhe procedurat që lidhen me transparencën, mbrojtjen e investitorëve, rregullat e sjelljes në treg dhe ato për parandalimin e pastrimit të parave (AML), për të siguruar përputhje me dispozitat e ligjit të ri.
- Është thelbësore të mbahet kontakt i ngushtë me zhvillimet rregullatore dhe udhëzimet që do të emetohen nga AMF dhe Banka e Shqipërisë për zbatimin efektiv të këtij ligji.

Action steps:

- Organizations involved in crypto-asset activities in Albania should thoroughly review their current operations, products, and services to identify potential impacts and ensure future compliance with the new regulatory requirements.
- Entities acting as CASPs or issuing ARTs/EMTs must familiarize themselves with the authorization and ongoing supervisory requirements to operate legally.
- Assess and update internal policies and procedures related to transparency, investor protection, market conduct, and anti-money laundering (AML) to align with the new law.
- Stay informed about further regulations and guidelines that will be issued by the AMF and the Bank of Albania to implement this law.

Burimi: Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë (Link)

Source: Official Gazette of the Republic of Albania (Link)



Ligji Nr. 57/2025
'Për menaxhimin e integruar të mbetjeve'

Ligji i ri Nr.57/2025 shënon një hap thelbësor drejt krijimit të një sistemi të integruar dhe efikas të menaxhimit të mbetjeve.Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik,duke promovuar efikasitetin e burimeve dhe tranzicionin drejt një ekonomie qarkulluese.

Parimet dhe Objektivat Kryesore:

Ligji thekson dy parime qendrore:

- **Hierarkia e mbetjeve:** Parandalimi, ripërdorimi, riciklimi, rikuperimi (përfshirë prodhimin e energjisë) dhe, si opsion i fundit, asgjësimi.
- **Parimi"Ndotësi paguan":** Përgjegjësia financiare për menaxhimin e mbetjeve bie mbi ata që i gjenerojnë ato.

Law No. 57/2025 'On Integrated Waste Management'

The new Law No. 57/2025, marks a significant step towards creating an integrated and efficient waste management system. This law aims to protect the environment and public health by promoting resource efficiency and the transition to a circular economy.

Key Principles and Objectives:

The law emphasizes two central principles:

- **Waste hierarchy:** Prevention, reuse, recycling, recovery (including energy generation), and, as a last resort, disposal.
- **"Polluter pays" principle:** Financial responsibility for waste management rests with those who generate it.

Përgjegjësitë e Subjekteve Kryesore:

- **Krijuesit dhe Zotëruesit e Mbetjeve:** Mbajnë përgjegjësi direkte për mbetjet e tyre.
- **Subjektet Prodhuese:** Kanë përgjegjësi të zgjeruar të prodhuesit (PZP) për menaxhimin e mbetjeve të produkteve të tyre.
- **Bashkitë:** Përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve bashkiake.
- **Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve (AKEM):** Do të transformohet në një shoqëri aksionare shtetërore për të administruar infrastrukturën fundore të trajtimit të mbetjeve (landfille dhe inceneratorë).

Rregullimi i Detajuar i Rrymave të Mbetjeve:

Ligji specifikon menaxhimin për kategori të ndryshme mbetjesh, duke përfshirë:

- Grumbullimin e diferencuar, magazinimin, transportin dhe trajtimin e mbetjeve.
- Mbetjet e rrezikshme: Ndalohet përzierja e tyre dhe kërkohen trajtime specifike.
- Vajrat e përdorura, bio- mbetjet, ambalazhet, plastikat njëpërdorimëshe, bateritë, automjetet në fund të jetës, mbetjet elektronike dhe spitalore.

Ndalimet Kryesore:

- Ndalohet importi i të gjitha mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme në Shqipëri.
- Ndalohet transiti i mbetjeve të rrezikshme.
- Ndalohen qeset plastike të lehta dhe ato okso-degradueshme.

Responsibilities of Key Stakeholders:

- **Waste Generators and Holders:** Bear direct responsibility for their waste.
- **Producer Entities:** Have extended producer responsibility (EPR) for managing the waste from their products.
- **Municipalities:** Responsible for the management of municipal waste.
- **National Waste Economy Agency (AKEM):** Will be transformed into a state-owned joint-stock company to administer the final waste treatment infrastructure (landfills and incinerators).

Detailed Regulation of Waste Streams:

The law specifies management for various waste categories, including:

- Differentiated collection, storage, transport, and treatment of waste.
- Hazardous waste: Mixing is prohibited, and specific treatments are required.
- Used oils, bio-waste, packaging, single-use plastics, batteries, end-of-life vehicles, electronic, and hospital waste.

Key Prohibitions:

- The import of all hazardous and non-hazardous waste into Albania is prohibited.
- The transit of hazardous waste is prohibited.
- Light plastic bags and oxo-degradable bags are prohibited.



Qeverisja dhe Zbatimi:

Kuadri i ri ligjor përfshin:

- Hartimin e Strategjisë Kombëtare të Mbetjeve, planeve zonale dhe vendore.
- Programe të detyrueshme parandalimi të mbetjeve.
- Kërkesa për leje mjedisore dhe licencim të veprimtarive tıë menaxhimit të mbetjeve.
- Sisteme të monitorimit, mbajtjes së të dhënave dhe raportimit të detyrueshëm.
- Sanksione me gjoba administrative për shkeljet, gjoba të cilat arrijnë deri në 20,000,000 lekë.

Ky ligj përfaqëson një përpjekje të gjithanshme për të modernizuar menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri dhe për të siguruar një mjedis më të pastër dhe më të qëndrueshëm për të gjithë.

Burimi: Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë (Link)

Governance and Implementation:

The new legal framework includes:

- The drafting of a National Waste Strategy, zonal and local plans.
- Mandatory waste prevention programs.
- Requirements for environmental permits and licensing of waste management activities.
- Compulsory monitoring, data retention, and reporting systems.
- Administrative fines for violations, which can reach up to 20,000,000 ALL.

This law represents a comprehensive effort to modernize waste management in Albania and ensure a cleaner and more sustainable environment for all.

Source: Official Gazette of the Republic of Albania (Link)



Contact us

PwC Albania

Address: Str. “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, 9/1 Tirana, Albania
Telephone: +(355) 42 242 254
Email: al_pwc_albania@pwc.com
Web: www.pwc.com/al

©2025 PwC. All rights reserved. PwC refers to the PwC network and/or one or more of its member firms, each of which is a separate legal entity. Please see www.pwc.com/structure for details. This content is for general information purposes only, and should not be used as a substitute for consultation with professional advisers.